



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr.Dok. 202002565/4

Tiranë 28 / 12 /2020

Lënda: *Rekomandim lidhur me përmirësimin e procedurave të mira administrative në kuadër të respektimit të të drejtës së qytetarëve për një proces të rregullt ligjor në procedurën administrative.*

Drejtuar: **BASHKISË**
Z.Kryetar

VAU-DEJËS

I nderuar z.Kryetar!

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, siç jeni në dijeni, ka paraqitur një ankesë shtetësja znj.S.Ç, e cila ka shprehur pretendimin dhe shqetësimin e saj ndaj Bashkisë Vau-Dejës lidhur me zgjidhjen e kontratës individuale të punës. Konkretisht ankuesja është shprehur se “.....është emëruar në detyrën e saj me datë 01.07.2016 dhe ka lidhur një kontratë individuale pune pa afat të përcaktuar dhe deri tani ka qenë korrekte dhe e angazhuar në përmbushjen e detyrave të saj funksionale. Ndërkohë që me datë 07.05.2020 është njoftuar për fillimin e procedurave për zgjidhjen e kontratës së saj të punës, duke i lënë një afat 2 mujor deri në largimin e saj nga puna. Ankuesja shprehet se ajo nuk është njohur asnjëherë me shkaqet dhe arsyet ligjore të zgjidhjes së kontratës së punës, duke e konsideruar këtë ndërprerje si të padrejtë, të paarsyetuar dhe të pabazuar.....”

Pas regjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit, i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka konstatuar se ankesa plotëson të gjithë kushtet thelbësore të formës dhe përmbajtjes për t’u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, nenet 13, 17/a dhe 18/b, ka vendosur t’a pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes.

I. RRETHANAT E RASTIT OBJEKT SHQYRTIMI

1. Me Vendim të kryetarit të bashkisë nr.118, datë 01.07.2016, si dhe referuar kontratës individuale të punës nr. 118/1, datë 01.07.2016 të lidhur mes Bashkisë Vau-Dejës si

punëdhënës dhe znj.S.Ç si punëmarrës, është lidhur marrëdhënia e punës me ankuesen znj.S.Ç në pozicionin inspektore protokollit në Sektorin e Informimit dhe Trajtimit të Ankesave, në Njësinë Administrative Bushat.

Në kuadër të riorganizimit të organeve të qeverisjes vendore, bazuar në ndarjen administrativo-territoriale të përcaktuar nga ligji nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenit 65, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Komuna Bushat e organizuar si njësi administrative, u bë pjesë e Bashkisë Vau-Dejës.

2. Me vendimin nr.11, datë 04.05.2020 “Mbi shpalljen e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ”, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në Kodin e Procedurave Administrative të RSH si dhe në ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, Kryetari i Bashkisë Vau-Dejës ka vendosur:

- 1. Konstatimin dhe shpalljen absolutisht të pavlefshëm të aktit administrativ Vendimi i Kryetarit të Bashkisë Vau-Dejës Nr. 118, datë 01.07.2016 “Emërimin në detyrë të znj.S.Ç në pozicionin “Inspektore e Protokollit dhe Arkivës në Njësinë Administrative Bushat”, i konstatuar kryesisht i pavlefshëm;*
- 2. Njësia përgjegjëse të bëjë rregullimin e pasojave juridike dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me znj.S.Ç si dhe shpalljen si vend të lirë pune të këtij pozicioni;*
- 3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.*

3. Me aktin administrativ nr.2403, datë 07.05.2020 “Njoftim” të Kryetarit të Bashkisë drejtuar ankueses, kjo e fundit është njoftuar për fillimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës individuale të punës.

4. Me aktin administrativ nr. 2403/1, datë 13.05.2020 “Njoftim për zgjidhjen e kontratës së punës” të Kryetarit të Bashkisë drejtuar ankueses, kjo e fundit është njoftuar se brenda një afati 2 (dy) mujor Bashkia e Vau-Dejës do të zgjidhë kontratën individuale të punës, duke filluar ky afat nga data e marrjes dijeni të këtij njoftimi.

5. Me vendimin nr.160, datë 20.07.2020 të Kryetarit të Bashkisë Vau-Dejës është vendosur zgjidhja e kontratës individuale të punës dhe ndërprerja e marrëdhënieve financiare më datë 20.07.2020.

II. QENDRIMI I BASHKISË VAU-DEJËS LIDHUR ME RASTIN

Për shqyrtimin me objektivitet të kësaj çështje dhe për të mundësuar një hetim të plotë administrativ, me tonën nr. K3/S27-2, datë 21.09.2020 kemi kërkuar nga Bashkia Vau-Dejës dhënien e shpjegimeve dhe një informacioni shterues lidhur me procedurat e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, cilat janë shkaqet dhe arsyet ligjore të iniciimit të këtyre procedurave, nëse i janë bërë të njohura këto shkaqe dhe arsye ligjore ankueses, cilat janë shkaqe dhe arsyet ligjore të shpalljes së pavlefshmërisë absolute të aktit të emërimit në detyrë të ankueses, nëse ankueja ka kryer shkelje administrative dhe nëse këto janë pasqyruar në dosjen e saj të punës, si dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me këtë çështje, duke synuar në sqarimin sa më të shpejtë dhe përfundimtar të pretendimeve të ngritura nga ankuesja

1. Me shkresën nr. 5473/1, datë 25.09.2020 Bashkia Vau-Dejës na ka informuar ndër të tjera si vijon:

“1 ... Marrëdhëniet e punës me Bashkinë Vau-Dejës i janë ndërprerë më datë 20.07.2020, për shkak të paligjshmërisë së emërimit në detyrë. Theksojmë gjithashtu se ankuesja nuk ka bërë ndonjë ankim në Bashkinë Vau-Dejës në lidhje me largimin nga puna.

2.....Kryetari i bashkisë ka konstatuar ekzistencën e rastit të parashikuar në nenin 108 të Kodit të Procedurave Administrative, të emërimit të znj.S.Ç dhe në respekt të dispozitës ligjore në fuqi ka nxjerrë Vendimin nr.11, datë 04.05.2020 me të cilin ka shpallur absolutisht të pavlefshëm Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.118, datë 01.07.2016 si dhe ka kërkuar Njësia të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore rregullimin e pasojave juridike dhe shpalljen si vend të lirë pune për konkurim të këtij pozicioni.

3.....Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka njoftuar punonjësen me shkresën nr.prot 2403, datë 07.05.2020, shkresë e cila i është dhënë dorazi më datë 08.05.2020. Më datë 11.05.2020 punonjësja është pritur në zyrën e Nënkryetarit të bashkisë ku i janë parashtruar argumentat ligjor të arsyes së zgjidhjes së kontratës individuale të punës.

4.....Pas këtij njoftimi ka filluar procedura e zgjidhjes së kontratës duke respektuar të gjitha procedurat dhe afatet e parashikuara në nenet 143,144 të “Kodit të Punës”, i ndryshuar. Njëkohësisht Njësia përgjegjëse ka shpallur për konkurim këtë pozicion pune me datë 03.07.2020, kjo me qëllimin e mirë që punonjësja të jepej mundësi për konkurim në këtë pozicion.

5.....Theksojmë se ky pozicion pune i mbuluar me kontratë nga subjekti Juaj i ankimit ka qenë i parashikuar për konkurim edhe në planin vjetor të pranimit në shërbimin civil, plan i cili është miratuar nga kryetari i bashkisë më datë 22.01.2020, i cili u është bërë i ditur të gjithë punonjësve të Bashkisë Vau Dejës, njëkohësisht edhe subjektit Tuaj ankimes me rastin e ristrukturimit të institucionit proces i cili është realizuar në muajin Janar 2020.”

2. Bashkëlidhur shkresës nr. 5473/1, datë 25.09.2020 të Bashkisë Vau-Dejës, janë dërguar dokumentat si më poshtë:

- Vendim nr. 19, datë 16.04.2016 i Kryetarit të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur, të emëruar, nëpunësit civil dhe punonjësit administrativ të Bashkisë Vau-Dejës për vitin 2016;
- Vendim nr. 291, datë 19.11.2019 i Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e strukturës organizative, organigramën, kategoritë dhe klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe administrativ për vitin buxhetor”;
- Vendim nr. 118, datë 01.07.2016 i Kryetarit të Bashkisë “Për emërim në detyrë të punonjësit”;
- Njoftim nr. 2403/1 datë 13.05.2020 për zgjidhjen e kontratës së punës;
- Vendim nr. 160, datë 20.07.2020 i Kryetarit të Bashkisë “Për zgjidhjen e kontratës individuale të punës”;
- Njoftim nr. 2403, datë 07.05.2020 ku shënohet se ankuesja ka marrë dijeni më datë 08.05.2020;
- Vendim nr. 11, datë 04.05.2020 i Kryetarit të Bashkisë “Mbi shpalljen e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ”;
- Procesverbal bazuar në njoftimin nr.2403, datë 07.03.2020 “Për fillimin e procedurave ligjore për zgjidhjen e kontratës së punës” i nënshkruar nga palët: punëmarrësi S.Ç dhe Punëdhënësi Kristian Shkreli;
- Vendim nr.2, datë 22.01.2020 i Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për vitin 2020”.

III. ANALIZA DHE VLERËSIMI I VEPRIMEVE ADMINISTRATIVE TË KRYERA.

Siç u përmend në hyrje të këtij rekomandimi, ankuesja është emëruar me Vendim të kryetarit të bashkisë nr.118, datë 01.07.2016, në pozicionin inspektore protokolli në Sektorin e Informimit dhe Trajtimit të Ankesave, në Njësinë Administrative Bushat.

Në kuadër të riorganizimit të organeve të qeverisjes vendore, bazuar në ndarjen administrativo-territoriale të përcaktuar nga ligji nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenit 65, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Komuna Bushat e organizuar si njësi administrative, u bë pjesë e Bashkisë Vau-Dejës¹.

Duke qenë se, marrëdhënia juridike e punësimit në ish komuna, më parë nuk rregullohej nga ligji për shërbimin civil², me hyrjen në fuqi të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar (më datë 26.02.2014), kjo marrëdhënie u përfshi në fushën e veprimit të këtij ligji³.

Rrjedhimisht, rezulton se në momentin kur ankuesja është emëruar me Vendim të kryetarit të Bashkisë nr.118, datë 01.07.2016 në pozicionin inspektore protokolli në Sektorin e Informimit dhe Trajtimit të Ankesave, në Njësinë Administrative Bushat, ky pozicion ka qënë pjesë e shërbimit civil.

Por, nga përmbajtja e Vendimit Nr. 118, datë 01.07.2016 dhe kontratës individuale të punës nr. 118/1, datë 01.07.2016 të lidhur mes Bashkisë Vau-Dejës si punëdhënës dhe znj.S.Ç si punëmarrës, rezulton se marrëdhënia e punës është lidhur referuar parashikimeve të Kodit të Punës, dhe jo dispozitave të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Për rrjedhojë, siç është konstatuar edhe nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil⁴, akti i emërimit si më sipër, ka dalë në kundërshtim me nenet 22, 23, 25 dhe 26 të, ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi nga këto norma ligjore sanksionohet se për çdo marrëdhënie të re pune që lidhet pas fillimit të efekteve të këtij ligji (pra pas datës 26.02.2014), duhet të respektohet detyrimisht një procedurë konkurrimi. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

¹ Referuar aneksit të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

²Baza ligjore ishte ligji Nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”, që në fushën e veprimit të tij sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 2 të tij përfshinte vetëm institucionet si vijon: Administrata e Kuvendit, Administrata e Presidentit, Aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore të pavarura , bashkitë dhe qarqet.

³Referuar nenit 2 paragrafi I dhe gërmës “b” të pikës 1 të nenit 4 të këtij ligji.

⁴ Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes dhe të vendimit nr. 70, datë 04.07.2018, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Vau-Dejës”, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Vau-Dejës. Në përfundim të mbikëqyrjes komisioneri ka nxjerrë raportin përfundimtar “Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Vau-Dejës” link: <http://www.kmshc.al/wp-content/uploads/2019/07/Bashkia-Vau-i-Dej%C3%ABs.pdf> i cili është miratuar me Vendimin Nr.39, Datë 19/04/2019 <http://www.kmshc.al/wp-content/uploads/2019/06/Vendim-Nr.39-Bashkia-Vau-i-Dej%C3%ABs.pdf>.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, jo vetëm për pozicionin që ka mbajtur ankuesja, por edhe për shumë pozicione të tjera, procedurat e punësimit për punonjësit e të cilëve kishin të njëjtën problematikë, ka lënë si detyrë që:

Kryetari i Bashkisë Vau-Dejës apo njësia përgjegjëse të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108 të Kodit të Procedurave Administrative, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve, si dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t'u plotësuar në përputhje me ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar⁵.

Për sa më lart, duke qënë se procedurat e administrimit të marrëdhënies në shërbimin civil në Bashkinë Vau-Dejës, kanë qenë objekt i mbikëqyrjes nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), i cili është institucion përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson të nevojshme dhe të arsyeshme të theksojë se problematika që parashtrohet në rastin konkret, nevojitet të adresohet nga institucioni ynë në një kontekst më të gjerë se ai marrëdhënies së ngushtë të shërbimit civil.

Konkretisht, pa dashur të ndërhyjmë në ushtrimin e detyrave funksionale nga ana e KMSHC, gjykojmë se procedurat administrative të ndjekura nga Bashkia Vau-Dejës për zbatimin e detyrave të lëna nga ky institucion për të mundësuar rivendosjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, paraqesin problematika të dukshme në drejtim të respektimit të parimeve për zhvillimin e një procedure administrative në përputhje me të drejtat dhe interesat e ligjshme të palës, që përbën në thelb të drejtën e palës për një proces të rregullt ligjor në procedurat administrative, parim ky i cili qendron në themel të shtetit të së drejtës.

Ky parim zërthehet e mishërohet në dispozitat e legjislacionit kuadër që rregullon organizimin dhe funksionimin e administratës publike shqiptare, si edhe në Strategjinë Ndërsëktoriale për Reformën e Administratës Publike 2015-2020, e cila është miratuar nga Këshilli i Ministrave në vitin 2015. Parimi i mirëqeverisjes shpreh detyrimin e organeve publike për të vepruar me transparencë, përgjegjshmëri dhe duke siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve. Qeverisja e mirë, si një koncept i cili po gjen gjithnjë e më tepër terren si tregues i performancës së shoqërive demokratike, ka në thelb garantimin e mbrojtjes së të drejtave legjitime e kushtetuese të shtetasve. Respektimi i këtij parimi, më tepër se nga politikat e mëdha e të bujshme të shtetit, fillon nga veprimtaria e përditshme e organeve të administratës publike, e cila në përputhje me Strategjinë për Reformën në Administratën Publike, por edhe me parimet e përgjithshme të administratës publike, duhet të sigurohet për të ruajtur balancën perfekte mes interesave e të drejtave të ligjshme të qytetarëve, dhe ushtrimit të diskrecionit publik. .

Në rastin konkret, procedura që është objekt shqyrtimi në këtë çështje, lidhet me një të drejtë kushtetuese thelbësore, që është e drejta e punës. Kjo e drejtë e individit e sanksionuar gjerësisht si nga aktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, por edhe nga

⁵Madje, duke qënë se numri i punonjësve të emëruar në kundërshtim me ligjin dhe i pozicioneve të punës të cilat janë të paplotësuara, në kohën e mbikëqyrjes zinte afërsisht 85% të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të punës që ishin pjesë e shërbimit civil, me qëllim që të mos krijoheshin vështirësi në funksionimin e institucionit, komisioneri ka rekomanduar që njësia përgjegjëse, fillimisht të planifikojë veprimtarinë për rregullimin e ligjshmërisë, duke hartuar një plan veprimi, me qëllim që, ndërprerja e marrëdhënieve të paligjshme të punës, të kryhej në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurimit.

Kushtetuta e nga legjislacioni shqiptar, do të mbetet me karakter deklarativ për sa kohë që nuk do të ketë transparencë, drejtësi e barazi në procedurat që zhvillon organi publik në ushtrim të pushtetit të tij.

Organi publik duhet të ushtrojë pushtetin diskrecional brenda kufijve të parashikuar me ligj, në një formë të tillë e cila të garantojë që procedura administrative prodhon rezultate të besueshme e objektive për të gjithë palët, përfshirë edhe palët të cilat preken nga vendimmarrja, siç është rasti i ankueses. Vetëm duke garantuar transparencë të plotë lidhur me procedurën administrative, organi publik mund të ofrojë dukshëm garanci. Pas analizimit me kujdes të shpjegimeve, si edhe të dokumentacionit të përcjellë, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se ka vend për përmirësim të procedurës administrative, që lidhet drejtpërdrejt me garantimin e të drejtës për një proces të rregullt administrativ.

Procesi i rregullt ligjor, i garantuar si e drejtë themelore e njeriut zbatohet edhe në procedurat administrative, ndonëse ai nuk është i parashikuar shprehimisht në ligjin horizontal për procedurat administrative (Kodi i Procedurave Administrative). Kjo e drejtë gjendet e pasqyruar dhe mishëruar plotësisht përmes elementëve thelbësorë të këtij parimi, të cilat janë ligjshmëria, transparenca, informimi, proporcionaliteti, drejtësia dhe paanësia, objektiviteti, përdorimi i gjuhës të njohur nga subjekti, e drejta e aksesit dhe përfaqësimit, e drejta e informimit, e drejta për t'u dëgjuar, kontradiktoriteti, koha e arsyeshme, arsyetimi i vendimmarrjes, e drejta e ankimit administrativ dhe gjyqësor, etj. E drejta për një proces të rregullt në procedurat administrative, e sanksionuar nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 6), Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 42), është një parim themelor kushtetues i konfirmuar tashmë nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, që shërben si garanci për subjektet e së drejtës nga veprime apo mosveprime të organeve të pushtetit shtetëror, e reflektuar gjerësisht në Kodin e Procedurave Administrative, i cili është ligji horizontal që rregullon organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë administrative dhe të administratës publike në tërësi.

Fusha e shtrirjes së procesit të rregullt ligjor edhe në proceset administrative ka qënë ndër vite edhe objekt i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese⁶, e cila në interpretim dhe analizë të nenit 42/1 të Kushtetutës së RSH, si edhe bazuar në nenin 6 (1) të KEDNJ ka konsoliduar qendrimin se e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter administrativ dhe se çdo organ i pushtetit publik gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor është i detyruar të respektojë standartet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë, pavarësisht nga natyra e procesit. Nga ana tjetër, interpretimi i dispozitës së nenit 6 të KEDNJ në këtë kuptim ka qënë vazhdimisht edhe objekt i jurisprudencës së GJEDNJ, e cila duke kritikuar rastet e interpretimit të ngushtë të nenit 6 të Konventës nga gjykata të vendeve palë në Konventë, ka pohuar se “*në shoqërinë demokratike, në kuptimin e Konventës, e drejta për një proces të rregullt ... zë një vend të rëndësishëm, sa që çfarëdo interpretimi i ngushtë i nenit 6(1) nuk do t'i përgjigjej as qëllimit dhe as karakterit të këtij neni*”⁶.

Ndaj, ndonëse fakti i pavlefshmërisë absolute të emërimit të ankueses (që mund të konstatohet në çdo kohë⁷) është një fakt që ekziston dhe do të ekzistonte edhe sikur të

⁶Vendimet nr. 75/2002, 76/2002, nr.6/2006, nr. 17/2010, nr.29/2013

⁶ Çështja Delecourt kundër Belgjikës, vendim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-57467>

⁷Sipas nenit 110, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative.

mos ekzistonin problematikat e konstatuara nga ana jonë (pasi emërimi i saj në shërbimin civil është kryer në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”), ky rekomandim do të trajtohet në nivel sistemik, për të adresuar problemet që kemi evidentuar në procedurën objekt shqyrtimi, dhe për të kontribuar në përmirësimin e procedurave të mira administrative që duhet të zbatojnë institucionet e administratës publike, e aq më tepër institucionet e pushtetit vendor si institucione që duhet të garantojnë standardet më të larta për qeverisje në nivel sa më afër qytetarëve.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se rasti është tepër kompleks, ndaj duhet të trajtohet në mënyrë të kujdesshme, duke harmonizuar dispozitat e Kodit të Punës, legjislacionit për shërbimin civil dhe Kodit Civil me parimet e përgjithshme të veprimtarisë administrative dhe dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

Në shpjegimet e përcjella nga Bashkia Vau-Dejës me shkresën nr. 5473/1, datë 25.09.2020⁸, thuhet se:

“3.....Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka njoftuar punonjësen me shkresën nr.prot 2403, datë 07.05.2020, shkresë e cila i është dhënë dorazi më datë 08.05.2020. Më datë 11.05.2020 punonjësja është pritur në zyrën e Nënkrjetarit të bashkisë ku i janë parashtruar argumentat ligjor të arsyes së zgjidhjes së kontratës individuale të punës.”

Në lidhje me këtë pohim, dëshirojmë të eidentojmë faktin se në dokumentacionin e përcjellë nga Bashkia Vau-Dejës, në kuadër të hetimit administrativ të zhvilluar nga institucioni i Avokatit të Popullit, rezulton se administrohet një akt “procesverbal” bazuar në njoftimin nr.2403, datë 07.03.2020 “Për fillimin e procedurave ligjore për zgjidhjen e kontratës së punës” ku thuhet se:

“Kryetari i Bashkisë sipas këtij njoftimi priti sot më datë 11.05.2020 ora 09⁰⁰ në zyrën e tij znj.S.Ç ku i parashtroi arsyen e fillimit të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës, si më poshtë vijon:

Znj.S.C u paraqit pranë Bashkisë Vau-Dejës dhe diskutoi me zv.Kryetarin për mundësitë e zgjidhjes së kontratës bazuar në njoftimin e marrë brenda afateve të parashikuara.”

Ky procesverbal është nënshkruar nga palët: punëmarrësi S.Ç dhe Punëdhënësi Kristian Shkreli.

Pas vlerësimit tepër të kujdesshëm të këtij akti, institucioni i Avokatit të Popullit konstaton se ai paraqet problematika si të formës, ashtu edhe të përmbajtjes.

Së pari, nisur nga forma e aktit, rezulton se ka pasaktësi në datën e njoftimit të punëmarrëses, që në akt citohet si dt. 07.03.2020, kur në fakt akti administrativ nr. 2403 “njoftim” që na është vendosur në dispozicion, mban datën 07.05.2020. Po kështu, në pjesën hyrëse të procesverbalit thuhet: “ ... Kryetari i Bashkisë sipas këtij njoftimi priti sot më datë ...”, ndërsa më poshtë thuhet se: “Znj.S.Ç u paraqit pranë Bashkisë Vau-Dejës dhe diskutoi me zv.Kryetarin”. Ndonëse mirëkuptojmë se bëhet fjalë për gabime njerëzore, mendojmë se është e rëndësishme që këto pasaktësi të sillen në vëmendje dhe të mbahet në konsideratë shmangia e tyre në të ardhmen.

Së dyti, lidhur me përmbajtjen e aktit procesverbal, i cili është një dokument ku shënohen ato që thuhën ose që vendosen në një mbledhje, rezulton se në aktin që na

⁸Të shtjelluara në mënyrë të detajuar në pikën 1 të Seksionit II të këtij rekomandimi “Qendrimi i Bashkisë Vau-Dejës lidhur me rastin”

është vendosur në dispozicion thuhet: “Znj.S.Ç u paraqit pranë Bashkisë Vau-Dejës dhe diskutoi me zv.Kryetarin për mundësitë e zgjidhjes së kontratës bazuar në njoftimin e marrë brenda afateve të parashikuara”.

Pra, ky akt nuk pasqyron as në ligjëratë të drejtë dhe as përmbledhtas çfarë konkretisht është diskutuar dhe argumentuar mes palëve, punëmarrësit dhe punëdhënësit.

E vendosim theksin në këtë fakt, pasi ky është dhe pretendimi kryesor i ankueses: nuk i janë bërë me dije arsyet konkrete të argumentuara për zgjidhjen e marrëdhënies së punës. Megjithatë, as në këtë akt dhe as në aktet e tjera administrative të vendosura në dispozicion⁹, siç janë vendimi për shpalljen e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, vendimi për zgjidhjen e kontratës individuale të punës, apo njoftimet drejtuar ankueses, nuk përmendet arsyeja e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.

Në këto akte administrative nuk citohet vendimi apo rapoti i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (i shpjeguar më lart), dhe as nuk arsyetohet për shkaqet e pavlefshmërisë absolute të aktit të emërimit të ankueses.

Vendimi nr. 11, datë 04.05.2020 “Mbi shpalljen e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ” shprehet vetëm se:

“Bazuar në nenin 8, pika 2 e ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” si dhe në nenet 108, 110, 111 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” në Republikën e Shqipërisë, në nenet 25, 26, 50/1 të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, vendosa: 1. Konstatimin dhe shpalljen absolutisht të pavlefshëm të aktit administrativ Vendimi i Kryetarit të Bashkisë Vau-Dejës Nr. 118, datë 01.07.2016 “Emërimin në detyrë të znj. S.Ç në pozicionin “Inspektore e Protokollit dhe Arkivës në Njësinë Administrative Bushat”, i konstatuar kryesisht i pavlefshëm; 2. Njësia përgjegjëse të bëjë rregullimin e pasojave juridike dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me znj.S.Ç si dhe shpalljen si vend të lirë pune të këtij pozicioni; 3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Njoftimi nr.2403, datë 07.05.2020 shprehet se:

“Bazuar në nenet 25, 26, 50/1 të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, në nenin 8, pika 2 e ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, në vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 11, datë 04.05.2020 “Mbi shpalljen e pavlefshmërisë absolute të aktit të emërimit në detyrë nr. 118, datë 01.07.2016”, Bashkia Vau-Dejës do të fillojë procedurën e zgjidhjes së kontratës individuale të punës me ju. Për sa më sipër ju njoftojmë se mbas mbarimit të afatit prej 72 orëve, duke filluar ky afat nga momenti i marrjes dijeni të këtij njoftimi, por nëçdo rast jo më vonë se 120 orë, ju duhet të paraqiteni në zyrën e Kryetarit të Bashkisë Vau-Dejës, brenda orarit zyrtar të punës, i cili do të parashtrijë përpara jush arsyen e mundësinë për zgjidhjen e kontratës individuale të punës me ju.”

Njoftimi nr.2403/1, datë 13.05.2020 shprehet se:

“Bazuar në nenin 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 11, datë 04.05.2020 “Mbi shpalljen e pavlefshmërisë absolute të aktit të emërimit në detyrë”, në njoftimin paraprak nr. 2403, datë 07.05.2020, ju

⁹ Të listuara në pikën 2 të Seksionit II të këtij rekomandimi “Qendrimi i Bashkisë Vau-Dejës lidhur me rastin”

njoftojmë se brenda një afati 2 (dy) mujor, Bashkia Vau-Dejës do të zgjidhë kontratën individuale të punës me ju, duke filluar ky afat nga data e marrjes dijani të këtij njoftimi. Ju njoftojmë se gjatë periudhës 2(dy) mujore të këtij afati ju përfiton 20 orë leje të pagueshme në javë.”

Vendimi nr. 160, datë 20.07.2020 i Kryetarit të Bashkisë “Për zgjidhjen e kontratës individuale të punës” shprehet se:

Bazuar në nenin 8, pika 2, nenin 64, gërma “g”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, në nenin 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, në vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 11, datë 04.05.2020 “Mbi shpalljen e pavlefshmërisë absolute të aktit të emërimit në detyrë”, në njoftimin e Bashkisë Vau-Dejës për zgjidhjen e kontratës individuale të punës nr. 2403/1, datë 13.05.2020, vendosa: Zgjidhjen e kontratës individuale të punës me punëmarrësin e Bashkisë Vau-Dejës znj.S.Ç e punësuar në pozicionin: “Specialiste në Sektorin e Protokollit dhe Arkivës”. Punëmarrësit i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare më datë 20.07.2020. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Sektori i Financës dhe Buxhetit.

Procedura e ndjekur nga Bashkia Vau-Dejës për rastin e ankueses është një procedurë administrative në kuptim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, i cili përcakton që procedura administrative është veprimtaria e një organi publik, me qëllim përgatitjen dhe miratimin e veprimeve konkrete administrative, ekzekutimin e tyre dhe rishikimin e tyre me mjete ligjore administrative¹⁰.

Akteve administrative të mësipërme u mungon elementi thelbësor i aktit administrativ: arsytimi. Arsyetimi i çdo akti administrativ, por veçanërisht i akteve që kanë për qëllim konstatimin apo shpalljen e pavlefshmërisë absolute të akteve të mëparshme, e që sjell pasoja për palën, siç është ndërprerja e marrëdhënies e punës, është mjaft i rëndësishëm dhe lidhet drejtpërdrejt me garantimin e të drejtës së palës për një proces të rregullt ligjor në procedurën administrative. Edhe aktet në fjalë, pavërsisht se lidhen me një marrëdhënie administrative të rregulluar nga një legjislacion i posaçëm, siç është marrëdhënia e punës, në thelb janë akte të prodhuara në kuadër të një procedure administrative, ndaj dhe është shumë e rëndësishme që organi publik në zhvillimin e procedurave administrative të cilësdo natyrë të respektojë edhe dispozitat e parimet e përgjithshme të veprimtarisë administrative, të rregulluara nga ligji përgjithshëm, që është Kodi i Procedurave Administrative.

Nenet 99 dhe 100 të Kodit të Procedurave Administrative, parashikojnë se:

Neni 99

Kërkesat e formës së aktit administrativ të shkruar në letër ose elektronik

1. Në çdo rast akti administrativ duhet të tregojë qëllimin e tij.

2. Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik përmban:

a) pjesën hyrëse, që përmban:

i) emrin e organit publik që nxjerr aktin;

ii) palët të cilave u drejtohet akti;

iii) datën e miratimit;

iv) bazën ligjore;

b) pjesën arsyetuese;

¹⁰Neni 3, pika 9 e KPrA

c) dispozitivin që tregon:

i) pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur;

ii) kohën e hyrjes në fuqi të aktit;

iii) të drejtën e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlogar itjes së tij për paraqitjen e ankimit.

3. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ i shkruar në letër përmban nënshkrimin, emrin dhe mbiemrin e shkruar të nëpunësit përgjegjës, apo përkatësisht të kryetarit dhe të sekretarit të organit kolegjial.

4. Akti administrativ elektronik nënshkruhet në mënyrë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto raste, kërkesat e pikës 3, të këtij neni, zëvendësohen me nënshkrimin elektronik të organit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 100

Arsyetimi i aktit

Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik, si dhe akti administrativ i konfirmuar, sipas nenit 98, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, duhet të jetë i arsyetuar.

Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:

a) shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti;

b) shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave;

c) bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast;

ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar.

Dispozitat e mësipërme lidhen drejtpërdrejt me respektimin e parimit të qartësisë dhe sigurisë juridike. Qëllimi i tyre është përcaktimi i kushteve juridike materiale dhe formale që çdo akt administrativ duhet të përmbushë. Qëllimi i të gjithë elementeve që duhet të përmbajë akti është që të garantojnë që pala të cilit i drejtohet akti të jetë në gjendje të kuptojë përmbajtjen faktike dhe juridike të vendimmarrjes administrative. Detyrimi ligjor i vendosur ndaj një organi publik nuk është vetëm plotësimi i listës së kërkesave në kuptimin e thjeshtë formal, por formulimi i tekstit në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme është po aq i rëndësishëm.

Në aktet në fjalë arsyetimi mungon, si në mënyrë të shprehur (i shpjeguar dhe argumentuar qartë) ashtu dhe në mënyrë indirekte (për shembull duke cituar gjermën/pikën konkrete të dispozitave përkatëse, apo raportin/vendimin e KMSHC). Organi publik është mjaftuar duke cituar nenin përkatës të KPRA që lidhet me pavlefshmërinë e aktit administrativ (neni 108, 110, 111) pa cituar shprehimisht pikën apo gjermën (rastin) nën të cilin klasifikohet konkretisht akti administrativ absolutisht i pavlefshëm i procedurës përkatëse, çka do të mund të shërbente si indicie për të kuptuar arsyet e pavlefshmërisë së këtij akti.

Faktin se pavlefshmëria e absolute e emërimit të ankueses është konstatuar për shkak se akti i emërimit fillestar ka dalë në kundërshtim me nenet 22, 23, 25 dhe 26 të, ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, çka është konstatuar edhe nga KMSHC nuk i është shpjeguar nga organi publik Bashkia Vau-Dejës as ankueses dhe as institucionit të Avokatit të Popullit. U desh një hetim administrativ i shtrirë në shumë drejtime nga institucioni ynë, duke hulumtuar vendimet e Komisionerit të Shërbimit Civil, për të identifikuar rastin konkret dhe për t’u informuar korrektësisht për çështjen.

Lidhur me procedurën e ndjekur për zbatimin e detyrave të lëna nga KMSHC

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të mbikëqyrjes ka lënë si detyrë që Kryetari i Bashkisë Vau-Dejës apo njësia përgjegjëse të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108 të Kodit të Procedurave Administrative, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve, si dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t'u plotësuar në përputhje me ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Lidhur me detyrën e parë të lënë nga KMSHC, për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative, gjatë hetimit administrativ kemi konstatuar sa më poshtë.

Në veprimet administrative¹¹ të kryera nga Bashkia Vau-Dejës, si më lart¹², vërehet se ka konfuzion dhe mungesë të një metodologjie të qartë administrative për të përmbushur detyrat e lëna nga Komisioneri në mënyrë të saktë dhe në përputhje me standardet që kërkon një proces i rregullt ligjor administrativ, por edhe në zbatim korrekt të dispozitave ligjore.

Komisioneri kërkon nga Kryetari i Bashkisë Vau-Dejës apo njësia përgjegjëse që të konstatohet në mënyrë të menjëhershme pavlefshmëria absolute e akteve administrative dhe të ndërpritet marrëdhënia e punës.

Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ (i cili në rastin konkret është vendimi nr.118, datë 01.07.2016 i Kryetarit të Bashkisë), sipas Kodit të Procedurave Administrative, me ndërprerjen e njeanshme të marrëdhënies së punës sipas Kodit të Punës (që në rastin konkret është kontrata individuale e punës nr. 118/1, datë 01.07.2016), janë dy institute të ndryshme të së drejtës.

Kontrata individuale e punës nr. 118/1, datë 01.07.2016 është lidhur bazuar në Vendimin nr.118, datë 01.07.2016 të Kryetarit të Bashkisë. Me Vendimin nr. 11, datë 04.05.2020, Kryetari i Bashkisë Vau-Dejës ka vendosur shpalljen e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ (vendimit të sipërcituar). Rrjedhimisht, me konstatimin e pavlefshmërisë absolute të këtij akti administrativ, ka rënë dhe fuqia juridike e kontratës së punës, si një veprim juridik i kryer në bazë të vendimit tashmë të konstatuar absolutisht të pavlefshëm, dhe në kundërshtim me ligjin.

Duke qënë një veprim juridik, kontrata e punës i nënshtrohet regjimit të pavlefshmërive, në rast se atakohen elementë të cilët janë parashikuar në mënyrë taksative nga legjislatori në Kodin Civil lidhur me pavlefshmërinë absolute apo atë relative. Duke qënë se, kodi i punës nuk rregullon institutin e pavlefshmërisë së kontratës së punës, atëherë rregullat e përgjithshme të kodit civil, mbi pavlefshmërinë e veprimit juridik do të gjejnë zbatim edhe për institutin e kontratës së punës, për aq sa nuk bien në kundërshtim me dispozitat e kodit të punës.

¹¹ "Veprim administrativ" është akti administrativ, kontrata administrative dhe çdo veprim tjetër administrativ (neni 3, pika 10 e KPrA)

¹²Shtjelluar gjerësisht nëSeksionet I dhe II të këtij rekomandimi "Rrethanat e rastit objekt shqyrtimi" dhe "Qëndrimi i Bashkisë Vau-Dejës lidhur me rastin"

Megjithatë, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me punonjësen, organi publik ka vijuar procedurën e zgjidhjes së kontratës individuale sipas nenit 144 të Kodit të Punës.

Mungesa e transparencës dhe informacionit lidhur me arsyet e përfundimit të marrëdhënies së punës, sëbashku dhe më zbatimin e gabuar dhe jo të harmonizuar të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, Kodit të Punës dhe Kodit Civil në këtë rast e ka orientuar krejt në mënyrë të gabuar të gjithë procedurën administrative, por edhe perceptimin e ankueses për rastin në fjalë.

Për këto arsye, vlerësojmë se procedura administrative në këtë pikë është e paqartë dhe e paplotë, duke mos krijuar garanci për respektimin e parimit të qartësisë dhe sigurisë juridike.

Lidhur me detyrën e dytë të lënë nga KMSHC, për shpalljen e pozicioneve për t'u plotësuar në përputhje me ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", gjatë hetimit administrativ kemi konstatuar sa më poshtë.

Me shkresën nr. 5473/1, datë 25.09.2020 Bashkia Vau-Dejës na ka informuar ndër të tjera si vijon:

4.....Njëkohësisht Njësia përgjegjëse ka shpallur për konkurim këtë pozicion pune me datë 03.07.2020, kjo me qëllimin e mirë që punonjëses ti jepej mundësi për konkurim në këtë pozicion.

Në kuadër të hetimit administrativ, bazuar në pikën 6 të Kreut II të VKM Nr. 243, datë 18.03.2015 i ndryshuar "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive"¹³, verifikuam faqen zyrtare të Bashkisë Vau-Dejës¹⁴ si dhe faqen zyrtare të ish Shërbimit Kombëtar të Punësimit¹⁵ sot Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive¹⁶.

Nga verifikimi i kujdesshëm i faqes zyrtare të institucionit të Bashkisë Vau Dejës, në seksionin e dedikuar për shpalljet e vendeve vakante¹⁷ gjetëm vetëm 3 njoftime të vjetra, të vitit 2017. Nga ana tjetër, shpalljet më të fundit të vendeve vakante (të vitit 2020) nuk i gjetëm as në seksionin e përgjithshëm të faqes të dedikuar për njoftimet e Bashkisë¹⁸, dhe as në ndonjë seksion tjetër të kësaj faqe.

Nga verifikimi i faqes zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive gjetëm të publikuar një njoftim të datës 03.07.2020, për shpallje vendi të lirë pune në pozicionin specialist protokoll arkive në Bashkisë Vau-Dejës, me përmbajtje si më poshtë:

13

BASHKIA VAU DEJËS VENDE TE LIRA PUNE

14] PER POZICIONIN

15] • Specialist në Sektorin e Protokoll-Arkivës

16] PER ME TERPER KLIDHNI NE LINKUN BASHKENGJETUR specialist protokoll arkive (2)

ag


17] <http://www.vaudejes.gov.al/njoftime-per-vende-te-lira-pune/>

18] <http://www.vaudejes.gov.al/njoftime/>

në shpalljen e procedurës së punësimit", në stendat e informimit

nizimit dhe të funksionimit të

Por, link në të cilin mund të aksesohet shpallja, e cila mendojmë se i përket pozicionit që ka mbajtur ankuesja, dhe të cilin Bashkia është shprehur se e ka publikuar me qëllimin e mirë që punonjëses ti jepej mundësi për konkurim në këtë pozicion, ishte i padisponueshëm:



Në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive gjetëm gjithashtu të publikuar një njoftim të datës 13.08.2020 ku thuhej se: Bashkia Vau-Dejës në zbatim të nenit 22 dhe 23 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të kreut IV, pika 13 e Vendimit nr 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve për pranim në shërbimin civil, njofton se për pozicionin Specialist në Sektorin e Protokollit dhe Arkivës, kandidat fitues është Merita Çeliku.

Nga kontakti telefonik me ankuesen më datë 10.12.2020, për t’u informuar nëse ajo kishte marrë pjesë në procedurën e konkurrimit, jemi informuar se ajo nuk kishte dijeni për shpalljen e pozicionit vakant, dhe as nuk i ishte komunikuar të konkurronte. Sigurisht që komunikimi me ankuesen për t’a ftuar atë të marrë pjesë në konkurim nuk është një detyrim institucional i Bashkisë. Por, nga ana tjetër, gjetjet tona, shpallja që mungon në faqen e Bashkisë dhe është e padisponueshme në faqen e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, dhe mungesa e komunikimit me ankuesen për t’a ftuar atë të marrë pjesë në konkurim, mendojmë se tregojnë qartësisht se nuk kanë shprehur në mënyrën e duhur qëllimin e mirë që punonjëses ti jepej mundësi për konkurim në këtë pozicion.

Lidhur me analizën e përgjegjësisë së strukturave në nivel hierarkik.

Pas marrjes dijëni për gjetjet e KMSHC nuk rezultojn të na jetë vendosur në dispozicion asnjë akt ku të analizohet përgjegjësia në nivel hierarkik ndërmjet strukturave të institucionit lidhur me emërimin e ankueses në kundërshtim me ligjin. Emërimi i ankueses në kundërshtim flagrant me procedurën e kërkuar nga ligji nuk mund të jetë kurrësi për faj të saj, ndaj rrjedhimisht ky është një dëm që është shkaktuar gjatë ushtrimit të detyrës nga personat përgjegjës që kanë kryer dhe lejuar vijimin e emërimit të nëpunëses në atë pozicion. Mendojmë se duke mbajtur parasysh pikërisht këto rrethana. Bashkia duhet të nxjerrë një raport të detajuar lidhur me personat përgjegjës që kanë shkaktuar këtë situatë, në analizë të plotë dhe të detajuar të legjislacionit që rregullon ushtrimin me përgjegjshmëri të funksioneve në administratën publike, për të siguruar respektimin e një procesi të rregullt ligjor:

- Nuk është analizuar se në ç'masë ka përgjegjësi për emërimin e ankueses në një pozicion pune në të cilin nuk plotësonte kriteret minimale të arsimit njesia e burimeve njerëzore?
- Në ç'masë ka përgjegjësi njesia e financës për ekzekutimin e pagesës të përmuajshme për rreth katër vite?
- Në ç'masë kanë përgjegjësi nivelet drejtuese të institucionit?

Mesa kuptohet nga dokumentacioni i përcjellë nga institucioni për Avokatin e Popullit, Bashkia Vau-Dejës është mjaftuar duke nxjerrë urdhërin për largimin e saj pa kryer një raport të detajuar lidhur me personat përgjegjës që kanë shkaktuar këtë situatë, si më lart.

Në përfundim, institucioni i Avokatit të Popullit konstaton se problematikat e konstatuara dhe të shpjeguara në këtë rekomandim në drejtim të procesit të rregullt ligjor në procedurat administrative, si dhe të kuptimit të drejtë dhe zbatimit të duhur të dispozitave dhe parashikimeve ligjore në procedurat administrative, në procedurat e marrëdhënies së punës por edhe në marrëdhënien juridike në përgjithësi vendosin në paqartësisht nevojën për përmirësimin e procedurave të mira administrative që duhet të zbatojnë institucionet e administratës publike, e aq më tepër institucionet e pushtetit vendor si institucione që duhet të garantojnë standardet më të larta për qeverisje në nivel sa më afër qytetarëve.

Për të gjitha sa më lart, bazuar Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 63/3, në të cilin thuhet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, neni 21/b në të cilin thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

REKOMANDOJMË:

- Bashkia Vau-Dejës të kryejë një analizë e të hartojë një relacion të plotë e të detajuar të masës së përgjegjësisë në nivel hierarkik ndërmjet strukturave të institucionit lidhur me emërimin e ankueses në kundërshtim me ligjin, duke konkluduar qartësisht të paktën lidhur me masën e përgjegjësisë së sektorit të burimeve njerëzore, sektorit juridik, të sektorit të financës, dhe nivelit hierarkik të institucionit duke adresuar drejt përgjegjësini tek personat përkatës;
- Bashkia Vau-Dejës të marrë masat e nevojshme për të siguruar trajnimin e vazhdueshëm dhe rritjen profesionale të stafit, sipas legjislacionit të shërbimit civil;

Brenda 30 ditësh nga marrja e këtij rekomandimi të njoftohemi për masat apo veprimet e ndërmarra nga bashkia Vau-Dejës.

Sipas nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar paraqitja e këtij rekomandimi pezullon aktet apo veprimet e paligjshme apo të parregullta deri në shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit.

Kërkesën për këtë informacion e mbështesim në nenin 63, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se: “Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentat dhe informacionet e kërkuara prej tij, si dhe në nenin 19, shkronja “b” të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ne të cilin thuhet: “Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin, si dhe duke besuar në zbatimin rigoroz të Ligjit nga ana Juaj,

KOMISIONERE

Prof.Asoc.Dr.Erjona BANA (CANAJ)